



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT:

KPCC/D/C/176/2012

DATA E VENDIMIT:

24/10/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi and Wühler

URDHËR

(1) Në 13 (trembëdhjetë) kërkesat e referua në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka dëshmuar pronësinë për pronën e kërkuar;

(2) Në secilën prej 13 (trembëdhjetë) kërkesave të identifikuara në paragrafin (1), Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi për pronën e kërkuar ose t'i jepet posedimi i tokës së bashkuar në të cilën ka qëndruar prona komerciale, sipas rastit;

(b) Çdo person, i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.

(3) Komisioni më tutje vendos që kërkesa nr. 25094 të hidhet poshtë, kur paraqitësi i kërkesës kërkon kompensimin për dëmin për pronën e kërkuar.

(4) Në 27 (njëzeteshtatë) kërkesat e identifikuara në pjesën C dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.

(5) Në kërkesat nr. 13399, 13400 dhe 13401, të identifikuara në pjesën E të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.

(6) Në rastet kur ka më shumë se një pronar vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e bashkëpronarëve respektive.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin i themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit.

(Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetenjë nga 22 deri 24 tetor 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 64 kërkesa për pronë komerciale në seancën e tridhjetenjë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Një kërkesë për pronë komerciale e cila i ishte referuar Komisionit, u tërhoq Sekretarisë Ekzekutive gjatë seancës dhe një kërkesë për pronë komerciale e cila i ishte referuar Komisionit, iu kthye Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni gjatë seancës. Gjithsej, 62 kërkesa për pronë komerciale u vendosën nga Komisioni gjatë seancës..

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Ky vendim përfshin 43 kërkesat për pronë komerciale të shënuara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej nëntëmbëdhjetë kërkesash për pronë komerciale përfshihen në vendimin KPCC/D/C/177/2012. Ky vendim trajton kërkesat për pronë komerciale të cilat në kohën e notifikimit të tyre nuk kanë qenë të dëmtuara, ose nëse kanë qenë të dëmtuara kanë pasur mundësi të meremetohen, ndërsa vendimi KPCC/D/C/177/2012 trajton kërkesa për prona komerciale të cilat janë konstatuar tërësisht të shkatërruara.

8. Në secilën prej këtyre kërkesave, me përjashtim të kërkesave nr. 00171, 00307, 01474, 11570 dhe 11572, paraqitësit e kërkesës kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore. Në kërkesat me nr. 00171, 00307, 01474, 11570 dhe 11572 paraqitësit e kërkesës kërkojnë konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

9. Komisioni vëren se 36 kërkesat e identifikuar në pjesët A, C dhe E të listës së bashkangjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni konstaton se Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t’i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohej nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksat e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksat e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksat e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

10. Komisioni më tej vëren më tej se shtatë kërkesat e identifikuar në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur, janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara (“Pala përgjegjëse”) ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme të procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, palës përgjegjëse i është ofruar një kopje e kërkesës të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Në përputhje me nenin 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësit të kërkesës, i është ofruar një kopje e dokumenteve të siguruara nga pala përgjegjëse në përgjigje të kërkesës. Të dy palëve në secilin rast, u është dhënë mundësia për të komentuar për informacionin e ofruar nga pala tjetër dhe komentet apo informacioni i tillë janë marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes së kërkesës.

I. Kërkesa jokontestuese - të miratuara

11. Komisioni vëren se në dymbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, përfshirë vendimet për trashëgiminë, fletët poseduese, certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme, kontratat e shitblerjes dhe vendimi i ndarjes. Komisioni konstaton se vendimet e trashëgimisë që konfirmojnë interesin pronësor me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Dokumentet e tjera të dorëzuara nga paraqitësit e kërkesave përfshirë kontratat që përfshijnë transaksione pronësore krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të së drejtës pronësore. Nuk është marrë ose nuk është kërkuar *ex officio* nga Sekretaria asnjë provë që do të kundërshtonte supozimin e të drejtës pronësore. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe konsiderohen si relevante. Shumë paraqitës të kërkesave kanë paraqitur dokumente mbështetëse shtesë përfshirë vendime të taksave, deklarata të dëshmitarëve, kopje të planeve dhe vendimeve kadastrale.

12. Në kërkesat nr. 10018, 10028, 10681, 13542, 17917, 17918 dhe 25094, të referuar në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Nisur nga konstatimet e Komisionit në paragrafin 11 më sipër, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

13. Në kërkesat nr. 08509, 92734, 92735 dhe 92736, të referuara në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhërësës Administrative e miratuar me ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë qëndruar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky përkufizim përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit, nipat/mbesat, stërgjyshërit, stërnipat/stërmbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave përfshihen në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në secilën kërkesë, siç është dhënë më sipër.

II. Kërkesa kontestuese - të miratuara

14. Në dy kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë (“pala përgjegjëse”), ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë, Komisioni ka arritur në përfundimin se kërkesat duhet të miratohen për arsyet e dhëna më poshtë.

15. Në kërkesat nr. 53752 dhe 53753 paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* një aktgjykim shkursorëzimi të vitit 1996 dhe një marrëveshje gjyqësore të vitit 1997, të lidhur para Gjykatës Komunale mes paraqitësit të kërkesës dhe ish bashkëshortit të saj, për ndarjen e pronës të përfutur gjatë martesës. Marrëveshja gjyqësore liston pronat e kërkuara (dy dyqane) në emër të paraqitësit të kërkesës. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

16. Pala përgjegjëse pohon se e ka blerë pronën e kërkuar nga bashkëshorti i paraqitësit të kërkesës në vitin 2006. Në mbështetje të pohimit, pala përgjegjëse ka paraqitur një kontratë shitblerje të verifikuar pozitivisht të vitit 2006 të lidhur mes palës përgjegjëse dhe bashkëshortit të paraqitësit të kërkesës. Megjithatë kontrata e paraqitur e shitblerjes nuk lidhet me pronat e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi tjetër në mbështetje të pohimit të tij.

17. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palës përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

III. Kërkesa të hedhura poshtë

18. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

19. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykate vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

20. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

1. Kërkesat nr. 00171, 00186, 00297, 00307, 33932 dhe 47464

21. Kërkesat nr. 00171, 00186, 00297, 00307, 33932 dhe 47464, të referuar në pjesën C dhe D të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar ose sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Kërkesat nr. 00171, 00186, 00297 dhe 00307, të referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur janë jokontestuese dhe kërkesat nr. 33932 dhe 47464, të referuara në pjesën D të listës së bashkangjitur, janë kontestuese në kuptimin që pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës.

22. Në të gjitha këto kërkesa, mbi bazën e dëshmive para tij, Komisioni konstaton se mbajtësi i së drejtës pronësore përkatëse ka përfituar vetëm të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit për pronën e kërkuar dhe për rrjedhojë është autorizuar të ndërtojë strukturë të lëvizshme në pronat e kërkuara. Rrjedhimisht të gjitha këto kërkesa kanë të bëjnë me pronë të luajtshme e jo pronë private të paluajtshme. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesa për riposedimin e pronës së paluajtshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë. Vendimi i Komisionit nuk cenon çfarëdo të drejtë që mund të kenë paraqitësit e kërkesës për të kërkuar kompensim para gjykatave vendore për investimet që kanë bërë në pronat e kërkuara apo ato që kanë sjellë rritjen e vlerës.

2. Kërkesat nr. 10013, 15120, 25863 dhe 35390

23. Kërkesat nr. 10013, 15120, 25863 dhe 35390, të referuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar ose sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Kërkesat nr. 11013, 25863 dhe 35390, të referuara në pjesën C të listës së bashkangjitur, janë jokontestuese. Kërkesa nr. 15120, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, është kontestuese në kuptimin se pala përgjegjëse ka shprehur interes ligjor në pronën e kërkuar dhe ka paraqitur mbrojtje për kërkesën, duke deklaruar se e ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës,

24. Në mbështetje të kërkesave të tyre, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dëshmive. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive në të gjitha këto kërkesa, ka marrë gjithashtu dëshmi të tjera ose që janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës dhe të verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive ose të siguruara nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio* dhe të cilat janë konfirmuar nga paraqitësi i kërkesës, mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ose anëtar i

bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore ku tregohet se pronat e kërkuara janë shitur tek një palë e tretë në bazë të kontratës së vlefshme të shitjes.

25. Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësit e kërkesës ose mbajtësit e së drejtës pronësore sipas rastit, nuk e kanë humbur posedimin për shkak të konfliktit 1998-1999, por si rezultat i shitjes vullnetare pas konfliktit, e cila tregon se ata kanë mundësi të ushtrojnë të drejtat pronësore. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

3. *Kërkesat nr. 34311 dhe 34343*

26. Kërkesat nr. 34311 dhe 34343 janë depozituar nga paraqitësit e kërkesave në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Të dyja kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ka shprehur interes ligjor në pronën e kërkuar dhe ka paraqitur mbrojtje për kërkesën. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësit e kërkesës kanë paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh.

27. Megjithatë, Komisioni vëren se në të dyja kërkesat dëshmitë e paraqitura nga paraqitësit e kërkesave ose të siguruara nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio*, tregojnë se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ka depozituar padi para datës 16 tetor 2006 në gjykatën kompetente duke kërkuar konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedimi gjyqësor për kërkesën para datës 16 tetor 2006, date në të cilën ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë.

4. *Kërkesa nr. 01474*

28. Kërkesa nr. 01474 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh, përfshirë një kontratë qiraje të verifikuar për pronën e kërkuar. Megjithatë kontrata e qirasë është lidhur në vitin 2000 dhe paraqitësi i kërkesës me pas ka konfirmuar se nuk ka qenë në posedimin e saj para kësaj date, duke pranuar kështu se humbja e pretenduar e pronës së kërkuar nuk lidhet me konfliktin e vitit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

5. *Kërkesa nr. 10679*

29. Kërkesa nr. 10679 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh përfshirë certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2010, e cila e tregon palën e tretë si pronar të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive bëri përpjekje për të kontaktuar paraqitësin e kërkesës për sqarim të mëtejshëm, megjithatë djali i paraqitësit të kërkesës konfirmoi se paraqitësi i kërkesës kishte ndërruar jetë ndërkohë. Djali i paraqitësit të kërkesës shpjegoi se babai i tij kishte jetuar në Gjermani që nga viti 1985, dhe kur u kthye në pronën e kërkuar pas konfliktit të vitit 1998-1999, prona e kërkuar nuk ishte uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

30. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se nuk ka pasur humbje të posedimit ose pamundësi për të ushtruar të drejtën pronësore për shkak të konfliktit të 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë për mungesë të juridiksionit.

6. *Kërkesa nr. 11743*

31. Kërkesa nr. 11743 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore të pretenduar për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Paraqitësi i kërkesës deklaron se Komuna e Klinës e ka uzurpuar pronën e kërkuar që nga vitet 1970. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh që lidhen me pronën e kërkuar duke përfshirë një vendim të verifikuar për shpronësimin të vitit 1977 të lëshuar nga Komuna e Klinës.

32. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se nuk ka pasur humbje të posedimit ose aftësisë për të ushtruar të drejtat pronësore për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit të 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë për mungesë të juridiksionit.

7. *Kërkesa nr. 11555*

33. Kërkesa nr. 11555 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së pretenduar të pronësisë për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Paraqitësi i kërkesës deklaron se Komuna e Rahovecit e ka uzurpuar pronën e kërkuar që nga vitet 1960. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh që lidhen me pronën e kërkuar duke përfshirë një vendim të shpronësimit të vitit 1965 me anë të të cilit Komuna e Rahovecit ka shtetëzuar pronën e kërkuar.

34. Komisioni konstaton se nuk ka pasur humbje të posedimit ose pamundësi për të ushtruar të drejtat pronësore për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit të 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë për mungesë të juridiksionit.

8. *Kërkesat nr. 00942, 00943, 00944, 00945 dhe 00958*

35. Kërkesa nr. 00942, 00943, 00944, 00945 dhe 00958 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në emër të Ndërmarrjes Shoqërore “Mehanizacija” si mbajtës i pretenduar i së drejtës pronësore (“Ndërmarrja”). Paraqitësi i kërkesës pretendon se ai është përfaqësues ligjor i ndërmarrjes, i autorizuar sipas rregullit, në cilësinë e drejtorit.

36. Në mbështetje të pohimeve të tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të panumërta, përfshirë vendimin e Gjykatës Komerciale të Prishtinës të vitit 1998, i cili deklaron se paraqitësi i kërkesës, në cilësinë e drejtorit mund të përfaqësojë ndërmarrjen pa kufizim gjatë periudhës së punësimit. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur gjithashtu kontratën e punësimit për periudhën 1998 deri 2003. Nuk ka dokumente të tjera të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës ose të siguruara *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive të cilat të vërtetojnë se paraqitësit të kërkesës i është vazhduar kontrata me ndërmarrjen pas vitit 2003. Rrjedhimisht, nuk ka dëshmi para Komisionit për të vërtetuar se paraqitësi i kërkesës është tani i autorizuar për të vepruar në emër të ndërmarrjes. Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për të treguar se ai vetë gëzon të drejta pronësore për pronën e kërkuar e po ashtu Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar *ex officio* dëshmi të tillë.

37. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se paraqitësit të kërkesës i mungon baza ligjore për të kërkuar në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

9. *Kërkesa nr. 34271*

38. Kërkesa nr. 34271 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, Ndërmarrjes Shoqërore “Serbija Prevoz.” Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së pronësisë të mbajtësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të panumërta përfshirë kontratën për ndërtim të përbashkët të vitit 1985 mes Ndërmarrjes Publike Banesore dhe Ndërmarrjes Shoqërore “Serbija Prevoz” bazuar në të cilën ky i fundit ka përfituar pronësinë e pronës së kërkuar. Kontrata është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

39. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore të ndërmarrjes shoqërore dhe jo pronës private. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesa për riposedimin e pronës së paluajtshme private. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

10. *Kërkesa nr. 08029*

40. Kërkesa nr. 08029 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, Ndërmarrjes Shoqërore “Lavotours.” Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së pronësisë të mbajtësit të së drejtës pronësore dhe riposedimin.

41. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të panumërta përfshirë vendimin administrative të vitit 1974 dhe 1979 që e lejon mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore të ngrejë një biznes në pronën e kërkuar. Megjithatë, Komisioni vëren se Sekretaria Ekzekutive e ka pasur të pamundur të verifikojë këto dokumente. Po ashtu, Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në emër të ndërmarrjes shoqërore. Rrjedhimisht kërkesa lidhet më prone shoqërore dhe jo prone private. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesa për riposedimin e pronës së paluajtshme private. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

11. *Kërkesa nr. 01044*

42. Kërkesa nr. 01044 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të panumërta përfshirë vendimin administrativ të vitit 2001 të lëshuar nga Ndërmarrja Shoqërore “Trepça” në bazë të të cilit paraqitësit të kërkesës i është miratuar e drejta e përkohshme e shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

43. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka përfituar të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit për pronën e kërkuar dhe për rrjedhojë ka pasur autorizim të ndërtojë një strukturë të lëvizshme mbi të. Rrjedhimisht, kërkesa lidhet më pronë të luajtshme e jo me pronë të paluajtshme private. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesa për riposedimin e pronës së paluajtshme private, përfshirë pronën komerciale. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit. Vendimi i Komisionit nuk cenon çfarëdo të drejtë që mund të kenë paraqitësit e kërkesës për të kërkuar kompensim para gjykatave vendore për investimet që kanë bërë në pronat e kërkuara apo ato që kanë sjellë rritjen e vlerës.

12. *Kërkesa nr. 11570, 11523 dhe 11572*

44. Kërkesat nr. 11570, 11523 dhe 11572 janë depozituar nga paraqitësit e kërkesave në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësit e kërkesave pohojnë të kenë të drejtën e shfrytëzimit për një strukturë komerciale (dyqan), megjithatë, ata kërkojnë vetëm kompensimin për dëmin fizik të pajisjes dhe mobilieve që i takojnë strukturës komerciale, që pretendohen të jenë si rezultat i konfliktit të 1998-99. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla kompensimi. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë.

IV. *Kërkesa të refuzuara*

45. Kërkesat nr. 13399, 13400 dhe 13401 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës, pikërisht në cilësinë e entitetit ligjor "Udarnik Commerce DOO," si mbajtës i pretenduar i së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës përfaqësohet sipas rregullit me përfaqësues ligjor të autorizuar. Kërkesa është jokontestuese. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar bazuar në një kontratë të ndërtimit të verifikuar pozitivisht të vitit 1997 të lidhur mes Ndërmarrjes Publike Banesore në bazë të secilës paraqitësi i kërkesës si kontraktues ka marrë detyrimet kontraktuese për të ndërtuar pronat e kërkuara për Ndërmarrjen Publike Banesore kundrejt pagesës. Paraqitësi i kërkesës deklaron se ndërtimet ishte kryer vetëm pjesërisht në kohën e konfliktit të 1998-99.

46. Komisioni vëren se në bazë të nenit 630 të Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet dhe nenit 6 të Ligjit për Ndërtimin e Objekteve Investuese, kontraktuesi ka vetëm të drejtën që t'i paguhen punimet ndërtuese, por nuk përfiton të drejtat pronësore për ndërtimin ose ndonjë pjesë të ndërtimit. Rrjedhimisht, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të refuzohet.

47. Komision vëren se paraqitësi i kërkesës kërkon gjithashtu kompensimin për punët e papaguara dhe materialet e investuara në pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut REG/2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

B. *Kërkesa për kompensim.*

48. Në kërkesën nr. 25094, referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, kërkesat nr. 00186, 10013, 11523, 115551, 1570, 11572, 15120 dhe 35390, referuar në pjesën B të listës së bashkangjitur dhe kërkesat nr. 13399, 13400 dhe 13401, referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës, kërkon gjithashtu përveç pronësisë, kompensimin për dëmin fizik ose për humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK/REG-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Për rrjedhojë kërkesa duhet të hidhen poshtë.

C. *Vërejtje përmblledhëse*

49. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

50. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke

aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

(a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo

(b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme e Kosovës mund të vjelë tarifën e gjyqësore për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA08509	KPA17917	KPA17918	KPA13542	KPA25094	KPA92734	KPA92735
KPA92736	KPA10018	KPA10028	KPA10681			

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA53752
KPA53753

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part C/Pjesa C/Deo C

KPA11572	KPA08029	KPA10679	KPA00171	KPA11523	KPA11555	KPA11570
KPA00186	KPA00297	KPA00307	KPA00942	KPA00943	KPA00944	KPA00945
KPA00958	KPA11743	KPA01474	KPA34271	KPA10013	KPA25863	KPA35390
KPA01044						

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part D/Pjesa D/Deo D

KPA15120	KPA33932	KPA34311	KPA34343	KPA47464		
----------	----------	----------	----------	----------	--	--

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part E/Pjesa E/Deo E

KPA13399
KPA13400
KPA13401